



**VENDIM NË KËRKESËN PËR RISHIKIM
SIPAS RREGULLIT 43 TË RREGULLORES Ë PUNËS SË PANELIT**

Data e miratimit: 4 qershor 2020

Numri i lëndës. 2016-28

S.H.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 4 qershor 2020, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues

Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar në Panel më 22 shtator 2016.
2. Me shkresën e datës 23 shtatorit 2016, Paneli ka informuar Misionin se kjo lëndë ishte regjistruar në Panel.
3. 28 qershor 2017, 9 shtator 2017 dhe 17 tetor 2017, Paneli ka kërkuar nga kjo dhe nga ankuesit e tjerë që të japin informata shtesë lidhur me ankesat e tyre.
4. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesve duke dhënë informacion shtesë në lidhje me dy raste, duke përfshirë edhe për këtë këtu.

5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli iu ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shifes së Misionit (ShM-së), EULEX-it Kosovë, duke e ftuar atë të parashtrojë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat jo më vonë se data 26 janar 2018.
6. Vërejtjet e ShM-së u morën më 16 tetor 2018, pas së cilës u janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.
- 7.
8. Më 28 mars 2019, Paneli shpalli se lënda ishte e pranueshme (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2019-03-28%20Admissibility%20Decision%202016-28-a.pdf>).
9. Më 14 maj 2019, ankuesi i kërkoi Panelit zgjatje të afatit bazuar në konsideratat personale relevante. Paneli e pranoi atë kërkesë dhe i lejoi ankuesit të paraqiste parashtresa shtesë jo më vonë se data 20 qershor 2019 në lidhje me meritën e lëndës dhe pyetjet e Panelit (shih, më lart, paragrafi 7). Parashtresat shtesë u pranuan nga ankuesi më 20 qershor 2019.
10. Më 17 maj 2019, ShM dërgoi përgjigjet dhe parashtresat e saj në Panel.
11. Më 11 shtator 2019, Paneli lëshoi Vendimin dhe Gjetjet e tij mbi meritat e kësaj lënde dhe gjeti se Misioni kishte shkelur të drejtat themelore të ankuesit ashtu siç garantohet, ndër të tjera, sipas nenit 2 (pjesët procedurale) dhe nenit 3 të Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2019-09-11%20Decision%20&%20Findings%202016-28-a%20signed.pdf>). Paneli arriti në atë pikëpamje duke u bazuar në një lloj dështimi të dyfishtë që i atribuohet Misionit:
 - i. Mos hetimi i plotë dhe me zell i lëndës; dhe
 - ii. Mos përfshirja dhe mos informimi siç duhet i viktimave.
12. Më 21 nëntor 2019, Misioni i shkroi Panelit për ta informuar atë për faktin se kishte gjetur një dokument shtesë për të cilin mendonte se mund të ndikonte në vendimin për meritat e Panelit në këtë rast. Misioni më tej ftoi Panelin që të rishikojë dokumentin në fjalë dhe të konsideroj rishikimin e vendimit të tij.
13. Më 11 dhjetor 2019, me përbërje të plotë, Paneli miratoi një ndryshim të Rregullit 43 të Rregullave të tij për të parashikuar në mënyrë të qartë mundësinë për Misionin (dhe jo vetëm ankuesin) të kërkojë një rishikim të gjetjeve të tij. Siç është ndryshuar, në Rregullin 43 tani thuhet si më poshtë:

Rregulla 43. Kërkesat për rishikimin e gjetjeve

1. Në rast të zbulimit të një fakti të ri, i cili për nga natyra e tij mund të ketë një ndikim vendimtar në gjetjet e Panelit dhe i cili, kur u dorëzuan gjetjet, ishte i panjohur për Panelin dhe nuk mund të dihej se në mënyrë të arsyeshme një palë, ai/ajo mund të kërkojë nga Paneli, brenda një periudhe prej një muaji pasi të vihet në dijeni të faktit, të rishikojë gjetjet.
2. Kërkesa do të specifikojë datën dhe rrethanat në të cilat u zbulua fakti i ri, pse nuk mund të ishte ditur në mënyrë të arsyeshme për palën që kërkonte një rishikim në kohën e paraqitjeve fillestare dhe të identifikonte gjetjet specifike të të cilave kërkohet rishqyrtimi për të vërtetuar se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafin 1. Kërkesa për rishikim duhet të shoqërohet me një kopje të të gjithë dokumentacionit mbështetës.

3. Paneli mund të refuzojë kërkesën nëse nuk ekziston asnjë arsye që kërkon rishqyrtimin e tij.
 4. Nëse Paneli vendos të konsideroj një kërkesë për rishikim për meritat e tij, ai do t'ia komunikojë palëve vendimin e tij për këtë qëllim dhe do t'i ftojë ata të paraqesin komente me shkrim brenda një afati kohor të përcaktuar nga Paneli.
 5. Kur ka vendosur të konsideroj një kërkesë për rishikim të meritës së tij, nën paragrafin 4, Paneli merr një vendim në lidhje me meritat e kërkesës për rishikim, në përputhje me rregullat 29 e tutje.
14. Më 11 dhjetor 2019, raportuesi në këtë rast vizitoi Misionin me qëllim të rishikimit të dokumentit në fjalë. Për aq sa mund të zbulohet, nga ai dokument është e qartë se ai përbën një deklaratë/procesverbal të intervistimit të një të afërmi të ankuesit. Ai daton pothuajse qe një dekadë dhe lidhet me një rast të krimeve të luftës, që në pikë ishte dukur u hetuar. Në atë deklaratë, i intervistuari jep informacion, *ndër të tjera*, rreth rrethanave të zhdukjes së babait të tij. Deklarata është marrë nga stafi i Misionit dhe duket se deklarata u dha më vonë si provë dhe u pranua në procedurë. Duket se i intervistuari nuk dha prova të drejtpërdrejta në gjykatë.
 15. Pasi shqyrtoi dokumentin në fjalë dhe në bazë të karakterit të tij konfidencial, Paneli është i bindur që fakti se ankuesi nuk kishte qasje në të nuk do të dëmtonte pozicionin e tij në këto procedura.
 16. Më 12 dhjetor 2019, Paneli iu përgjigj letrës së Misionit të datës 21 nëntor. Në letrën e tij, Paneli informoi Misionin se kishte ndryshuar Rregullin 43 të Rregullores së tij të Punës për të autorizuar zyrtarisht Misionin (dhe jo vetëm ankuesin) për të kërkuar rishikimin e gjetjeve të tij. Paneli gjithashtu njoftoi Misionin se nëse Misioni kishte për qëllim ta bënte këtë në këtë rast, pritej të bënte një kërkesë zyrtare për këtë qëllim dhe të demonstronte që kriteret e Rregullës 43 ishin përmbushur. Në veçanti, Paneli i kërkoi Misionit të sigurojë 'informacione të hollësishme në lidhje me datën dhe rrethanat në të cilat u identifikuan informacionet e reja dhe të specifikojë gjetjet për të cilat ju sugjeroni se po ndikohen nga kjo informatë dhe arsyen pse, sipas mendimit tuaj, ato prekin ato gjetje'.
 17. Më 20 Janar 2020, Misioni përmes ushtruesit të Detyrës së shefit të Misionit i shkroi përsëri Panelit në lidhje me këtë çështje që të kërkojë zyrtarisht rishikimin e gjetjeve të Panelit në lëndën 2016-28 bazuar në dokumentin e zbuluar rishtazi.
 18. Më 22 janar 2020, Paneli ia përcolli ankueses letrën e Misionit të datës 20 janar dhe i kërkoi atij që të bënte ndonjë parashtresë shtesë në lidhje me dokumentin e zbuluar rishtazi jo më vonë se me datën 20 shkurt 2020. Ankuesi nuk e shfrytëzoi këtë mundësi.

GJETJET RELEVANE NË LIDHJE ME MERITËN

19. Më 11 shtator 2019, Paneli gjeti si më poshtë në seksionet përkatëse të vendimit të tij:

Mos informimi i të afërmeve të viktimës

76. Është vërejtur më lart se nuk ka asnjë indikacion në procesverbalin e Misionit që ka përmbushur detyrimin e tij për të informuar ankuesin për ekzistencën, mënyrën dhe karakterin e hetimit (shih, paragrafi 38 më lart).

77. Një kriter i tillë është një element i domosdoshëm i mbrojtjes së të drejtave të viktimave në hetimin e një rasti të tillë. Shih, p.sh., *Desanka dhe Zoran Stanisic kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66, duke iu referuar *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-74; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 86; shih gjithashtu *Ahmet Özkan dhe të Tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj-së i dates 6 prillit 2004, par. 311-314, *Isayeva kundër Ruisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj-së, paragrafët 24 shkurt 2005. 211-214; *Al-Skeini dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrik 2011, par. 167.
78. Ky detyrim është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e incidenteve të zhdukjes me forcë kur viktimat vuajnë emocionalisht nga mungesa e informacionit në lidhje me fatin e të dashurve të tyre. Shih *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87. Duke nënvizuar të drejtën e viktimave për të vërtetën në këtë kontekst, Komenti i Përgjithshëm i Grupit të Punës për Zhdukjen me Forcë për këtë çështje thotë si më poshtë:

“Neni 13 i Deklaratës njih obligimin e shtetit për të hetuar rastet e zhdukjeve me forcë. Paragrafi 4 i nenit 13 specifikon se "gjetjet e një hetimi të tillë do të vihen në dispozicion sipas kërkesës për të gjithë personat e interesuar, përveç nëse kjo do të rrezikonte ndonjë hetim penal që është në vazhdim e sipër”. Në bazë të zhvillimeve të ndodhura që nga viti 1992, Grupi i Punës gjykon se kufizimi në pjesën e fundit të këtij paragrafi duhet të interpretohet ngushtë. Në të vërtetë, të afërmit e viktimave duhet të lidhen ngushtë me një hetim për një rast të zhdukjes me forcë. Refuzimi për të dhënë informacion është kufizim i së drejtës për të vërtetën. Një kufizim i tillë duhet të jetë rreptësishtë proporcional me qëllimin e vetëm të ligjshëm: të shmangë rrezikimin e një hetimi penal në vazhdim. Një refuzim për të dhënë ndonjë informacion, ose për të komunikuar me të afërmit fare, me fjalë të tjera një refuzim i plotë, është një shkelje e së drejtës për të vërtetën. Sigurimi i informacionit të përgjithshëm për çështjet procedurale, siç është fakti që çështja i është dhënë një gjykatësi për shqyrtim, është i pamjaftueshëm dhe duhet të konsiderohet shkelje e së drejtës për të vërtetën. Shteti ka për detyrë të njoftojë çdo person të interesuar rreth hapave konkretë të ndërmarrë për të sqaruar fatin dhe vendndodhjen e personit. Një informacion i tillë duhet të përfshijë hapat e ndërmarrë në bazë të provave të siguruar nga të afërmit ose dëshmitarët e tjerë. Ndërsa nevojat e një hetimi penal mund të justifikojnë kufizimin e dhënies së informacionit të caktuar, duhet të ketë ndonjë mjet juridik në legjislacionin vendor për të shqyrtuar një refuzim të tillë për të dhënë informacionin për të gjithë personat e interesuar. Ky shqyrtim duhet të jetë i disponueshëm në kohën e refuzimit fillestar për të dhënë informacion, dhe pastaj në mënyrë të rregullt për të siguruar që arsyeja e nevojës që u kërkua nga autoriteti publik të refuzojë të komunikojë, mbetet e pranishme. ”

Shih *Komentet e Përgjithshme mbi të Drejtën në të Vërtetën në Marrëdhëniet ndaj Zhdukjes me forcë*, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë ose të pavullnetshme (2010), Dokumenti A/HRC/16/48, paragrafi 3; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87; dhe gjithashtu, *lënda I. e Rio Negro Massacres kundër Guatemalës*,

Aktgjykimi i IACtHR i 4.09.2012, kundërshtimi paraprak, meritat, riparimi dhe kostot, par. 265.

79. Misioni nuk dha ndonjë shpjegim për mos mbajtjen e ankuesit (ose ndonjë të afërm të ngushtë të viktimës parësore) të informuar në lidhje me këtë rast. Fakti që të dhënat e tij heshtin në atë pikë flet vetë.
 80. Ky dështim kontribuoi në shkeljen e të drejtave të ankuesit për aq sa shtoi gjendjen e pasigurisë në të cilën ai e gjeti veten gjatë gjithë periudhës përkatëse.
20. Paneli më vonë zbuloi se ky dështim - si dhe dështimi i Misionit për të hetuar siç duhet dhe plotësisht këtë rast - kishin shkelur të drejtat e ankuesit sipas nenit 2 (pjesët procedurale) dhe nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

PARASHTRESAT E PALËVE NË LIDHJE ME KRITERET E RREGULLIT 43

21. Paneli tani vendos që ta shqyrtojë dokumentin e ri në bazë të rregullës 43 të Rregullores së tij të Punës.
22. Në letrën e tij të datës 20 janar 2020, Misioni shpjegoi se kërkesa e tij për rishikim vinte nga zbulimi më datën 28 tetor 2019 të një fakti të ri, i cili u soll në vëmendjen e Panelit, për të cilin tha se ishte i panjohur për Misionin në koha e paraqitjes së vërejtjeve të tij për pranueshmërinë dhe meritat e ankesës. Misioni më tej argumentoi se fakti në fjalë, nëse do të dihej në atë kohë, mund të kishte ndikuar në gjetjet e Panelit.
23. Sipas Misionit, 'fakti i ri' në fjalë është se një i afërm i ankuesit dha një deklaratë (si "Dëshmitari R") që ishte ofruar në procedurat penale të nisura nga EULEX-i në lidhje me, *ndër të tjera*, zhdukjen e babait të ankuesit. Duket se individ i në fjalë nuk dha prova të drejtpërdrejta në këtë rast, por deklarata e tij u lexua në procesverbalin e lëndës dhe kështu ishte bërë pjesë e procesverbalit të atyre procedurave.
24. Në lidhje me rrethanat që çuan në zbulimin e këtij dokumenti, Misioni sqaron se, pasi mori vendimin e Panelit të datës 11 shtator 2019, më 7 tetor 2019, Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Ligjore (ZDNjÇL) kreu një 'kontroll të mëtutjeshëm në të dhënat elektronike të ZPSK të EULEX-it dhe NjHKL për rastin, në mënyrë që të sigurohet se asgjë nuk ishte anashkaluar'. Këto të dhëna janë në dispozicion të ZDNjÇL që nga janari i vitit 2019. Ato përbëhen nga rreth 60 dosje që përmbajnë dokumente të formatit PDF, të cilat nuk mund të kërkohen në mënyrë elektronike.
25. Ky dokument ishte zbuluar në ato të dhëna më 28 tetor 2019. Siç u tregua edhe më sipër, ai përbëhet nga një deklaratë e marrë nga një i afërm i ankuesit nga NjHKL të EULEX-it më 22 dhjetor 2010. Në atë deklaratë, individ përmend që është intervistuar nga UNMIK-u vite më parë dhe se ai ishte i lidhur me familjen e të zhdukurit. Deklarata e UNMIK-ut nuk është në dispozicion të Panelit.
26. Më 25 korrik 2011, si pjesë e procedurës penale në fjalë, duke vepruar me nismë të Prokurorit të EULEX-it, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori një urdher për masa mbrojtëse në lidhje me disa dëshmitarë të lëndës, përfshirë edhe atë që ka dhënë deklaratë që është subjekt i aplikacionit këtu. Si rezultat, emri i tij u bë anonim dhe hollësitë e kontaktit të tij ishin konfidenciale.
27. Duke iu drejtuar pyetjes se përse fakti i ri i pretenduar dhe deklarata e bashkëngjitur nuk mund të ishin me arsye në dijëni të EULEX-it në një kohë më të hershme, Misioni vëren

se para janarit 2019, ZDNjÇL nuk kishte mundësinë të kërkonte dosjet e ZPSRK apo NjHKL si këto njësi dhe të dhënat e tyre ishin në institucionet e Kosovës. Misioni shton atë

'Duket se në tetor 2018, kur u dha informacioni [në lidhje me pranueshmërinë e lëndës] për lëndën 2016-28 për ZDNjÇL me qëllim të përgatitjes së vërejtjeve fillestare të EULEX-it për rastin, këto njësi nuk kërkuan pjesën e dosjes së lëndës përkatëse që përmbajnë të dhëna personale për dëshmitarët e mbrojtur, dhe për këtë arsye nuk u njoftuan se i afërmi i ankuesit dhe babai i ankuesit ishte njëri prej tyre. Kjo mund të ketë qenë për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme dhe presionit në të cilin njësitë e përmendura po vepronin në pritjen e afatit për përfundimin e procesit të dorëzimit tek institucionet e Kosovës. Për më tepër, pasi që lënda ishte vendosur në nivelin e Gjykatës Supreme në maj 2017, dosja përkatëse e ZPSRK-së tashmë ishte arkivuar dhe nuk ishte shqyrtuar para dorëzimit nga EULEX-i [...]. Fakti që ankuesi nuk përmend përfshirjen e dëshmitarit 'R' në procedurën penale nuk kontribuoi që EULEX-i të njoftohej për këtë në vjeshtën e vitit 2018'.

28. Në këtë bazë, Misioni kërkon një rishikim të gjetjeve të Panelit në paragrafët 75-80 të Vendimit të tij dhe të përmbledhur nën titullin "mos informimi i të afërmeve të viktimës" (shih, më lartë, paragrafin 18). Misioni pohon se mund të konstatohet se nga 11 nëntori 2011 e tutje (kur filloi gjykimi në këtë rast), ankuesi u njoftua zyrtarisht për procedurën penale. Misioni shton:

'Është e qartë se ai ishte gjithashtu në dijeni për rezultatin përfundimtar të një procesi të tillë, pasi ai indirekt e tregon këtë në formën e ankesës të regjistruar nga PShDNj-ja më 22 shtator 2016'.

Misioni më tej kërkon të pohojë që për shkak se "Dëshmitari R" ishte intervistuar, ai duhej të ketë folur në emër të të gjithë familjes dhe se familja e tij (përfshirë, nënkuptohet ankuesi) duhet të ketë qenë i informuar për hetimin e kësaj lënde.

29. Mbi këtë bazë, Misioni përfundon se konstatimi i Panelit që EULEX-i nuk arriti të informojë të afërmit e babait të ankuesit për ekzistencën, rrjedhën dhe karakterin e hetimit duhet të rishikohet. "Në të kundërt", Misioni pohon, "përkundër rrethanave sfiduese, është e qartë se Misioni bëri çmos" për të balancuar të drejtat dhe interesat e viktimave për t'u informuar për përparimin e hetimit me shkallën e nevojshme të konfidencialitetit që një hetim mund të kërkojë në mënyrë të ligjshme".
30. Misioni nuk parashton se baza alternative dhe e pavarur mbi të cilën Misioni u konstatua se kishte shkelur të drejtat e ankuesit (d.m.th., përmes një hetimi jo adekuat të lëndës) është në ndonjë mënyrë e prekur nga zbulimi i faktit të ri.

DISKUTIME

A përbën ndonjë "fakt të ri" baza e aplikacionit?

31. Rregulla 43 parasheh që një kërkesë për rishikimin e një Vendimi të Panelit mund të bëhet pas zbulimit të "një fakti të ri". Një "fakt i ri" në këtë kontekst nënkupton një ngjarje, një rrethanë ose një faktor që bart në thelb çështje të rëndësishme rreth lëndës ose që është e lidhur materialisht me konsideratat faktike të rëndësishme për lëndën. Ajo duhet të jetë 'e re' në kuptimin që ajo ishte e panjohur për Panelin dhe nuk mund të ishte njohur në mënyrë të arsyeshme për një palë në kohën e procedurës kryesore. Kjo gjithashtu nënkupton që fakti në fjalë nuk duhet thjesht të përbëjë një përsëritje në një formë tjetër të një fakti të konsideruar tashmë nga Paneli.

32. Paneli është i bindur që fakti i paraqitur nga Misioni - d.m.th., ekzistenca e një interviste të marrë nga stafi i EULEX-it i një të afërmi të ankuesit që prek ndër të tjera zhdukjen e të afërmeve të tyre - përbën një fakt të ri për qëllimin e Rregullit 43 të Rregullores së Punës së Panelit.

Afati një mujor për të aplikuar për rishikim - Rregulla 43, paragrafi 1

33. Rregulla 43, paragrafi 1, i Rregullores së Punës së Panelit parasheh që atëherë kur është zbuluar një fakt i ri, pala në fjalë mund të kërkojë nga Paneli, brenda një periudhe prej një muaji pasi të jetë në dijeni të faktit, të rishikojë gjetjet.
34. Në këtë rast, afati kohor i mëposhtëm është i rëndësishëm:
- i. **Më 11 shtator 2019**, Paneli lëshoj Vendimin dhe Gjetjet e tij;
 - ii. **Më 28 tetor 2019**, Misioni zbulon 'faktin e ri' në formën e një deklaratë të dëshmitarëve;
 - iii. **Më 21 nëntor 2019**, Misioni i shkroi Panelit për ta informuar atë për faktin se kishte identifikuar deklaratën e thënë;
 - iv. **Më 11 Dhjetor 2019**, Paneli ndryshon Rregulloren 43 të Rregullores së saj të Punës;
 - v. **Më 12 dhjetor 2019**, Paneli iu përgjigj letrës së Misionit të datës 21 nëntor dhe fton Misionin të bëjë një kërkesë në përputhje me Rregulloren 43 nëse dëshiron;
 - vi. **Më 20 janar 2020**, Misioni zyrtarisht ka aplikuar për një rishikim në përputhje me Rregullën 43.
35. Paneli vëren se ka kaluar më shumë se një muaj midis ndryshimit të rregullës 43 (11 dhjetor 2019) dhe kërkesës zyrtare të Misionit të paraqitur në bazë të këtij rregulli (20 janar 2020).
36. Duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të kësaj lënde dhe faktit që Misioni e kishte njoftuar Panelin më pak se një muaj pasi ta zbulonte faktin e ri, Paneli nuk do ta hedhë poshtë këtë kërkesë.

Kriteret e kujdesit dhe afatit nga ana e aplikantit

37. Rregulla 43 nënkupton që pala në fjalë duhet të ketë ushtruar një kujdes të arsyeshëm në marrjen e dokumenteve dhe informacioneve të rëndësishme për procedurat. Siç shprehet në Rregullën 43, aplikanti duhet t'i tregojë Panelit që fakti dhe informacioni i rëndësishëm për aplikimin e tij nuk mund të ishin të njohura në mënyrë të arsyeshme për njërën palë.
38. Në lidhje me pyetjen nëse Misioni e ka përmbushur këtë kërkesë, Paneli dëshiron të nënvizojë sa vijon.
- i. *Së pari*, nga raporti i vetë Misionit, kërkimi i tij për dokumente shtesë u bë me vendim të Panelit të datës 11 shtator 2019.

- ii. *Së dyti*, regjimi institucional dhe procedural i zbatueshëm përpara Panelit nuk parashikon ankesë ose një sistem të instancave të shumta. Prandaj, ekziston një supozim i brendshëm se të gjitha faktet dhe konsideratat që lidhen me Vendimin e Panelit duhet të vendosen para tij në kohën përkatëse, d.m.th. para se të vendosë një vendim mbi meritat e lëndës. Kjo, nga ana tjetër, e obligon palën për kujdes për të siguruar që ata kanë kryer një rishikim të plotë të të dhënave të tyre për të siguruar që të gjitha informacionet përkatëse janë vendosur para Panelit në atë kohë.
 - iii. *Së treti*, dhe në bazë të pikës së mëparshme, një Vendim i Panelit mbi meritat e një lënde nuk shkakton një proces të ri me të cilin një palë e dëmtuar mund të kërkojë të rrezojë atë Vendim bazuar në materialin që ka kërkuar të marrë pas këtij Vendimi. Kjo është e rëndësishme për të siguruar përsheptimin, drejtësinë, efektivitetin dhe përfundimin e procedurave. Gjithashtu është thelbësore të sigurohet që kujdesi ushtrohet nga të gjithë në çdo fazë të procedurave para Panelit. Me fjalë të tjera, procesi i rishikimit i dhënë sipas Rregullës 43 nuk mund të përdoret si një mjet për të "apeluar" në mënyrë efektive një vendim të Panelit. Është dhe duhet të mbetet, një procedurë e jashtëzakonshme - që merret me situata kur një palë ka zbuluar me mirëbesim fakte të reja që nuk mund të ishin njohur në një kohë të hershme, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të duhur të pritshëm.
39. Duke zbatuar parimet dhe konsideratat e mësipërme për lëndën në fjalë, Paneli vëren si në vijim.
 40. Së pari, Paneli vëren se deklarata në fjalë ishte në zotërim të Misionit në çdo kohë të rëndësishme për këto procedura. Përderisa ZDNjÇL mund të mos kishte qasje në atë informacion, pjesë të tjera të Misionit (veçanërisht NjHKL) e kishin atë. Është pjesë e përgjegjësisë së Misionit në lidhje me procedurat para Panelit për të siguruar që informacioni përkatës kërkohet dhe merret nga të gjitha organet përkatëse të Misionit.
 41. Së dyti, përderisa Misioni thotë se nuk mund të kërkonte ato të dhëna deri në janarin e vitit 2019, Paneli thekson që paraqitjet e Misionit për meritat e kësaj lënde ishin paraqitur më 17 maj 2019, d.m.th., më shumë se katër muaj pasi ajo u bë e kërkueshme.
 42. Së treti, përderisa Paneli shpjegon sfidat që mund të ishin përfshirë në atë proces, një sfidë e tillë nuk duhet të ekzagjerohet. Misionit iu desh pak më shumë se një muaj për të gjetur atë deklaratë sapo filloi ta kërkonte. Në ato rrethana, Misioni nuk ka arritur të shpjegojë pse ky dokument nuk mund të ishte gjetur në ushtrimin e arsyeshëm të kujdesit të tij para paraqitjes së tij më 17 maj 2019.
 43. Së katërti, siç u vu në dukje, vendimi i Misionit për t'u rikthyer në të dhënat e tij ishte nxitur nga Vendimi i Panelit i datës 11 shtator 2019. Në përputhje me ato që u thanë më lart në lidhje me procedurën e Panelit, një vendim i trupit gjykues në lidhje me meritën e një lënde nuk shkakton ndonjë raund të dytë të procedurave.
 44. Bazuar në çfarë u përmend më sipër, Paneli konstaton se nuk mund të thuhet se, në përputhje me Rregulloren 43, fakti i ri që i nënshtrohet kësaj kërkesë nuk mund të kishte qenë në dijeni të Misionit në mënyrë të arsyeshme. Kërkesa e Misionit për një rishikim mund të refuzohet mbi këto arsye. Sidoqoftë, dhe në mënyrë që të sigurojë që rekomandimet e Panelit janë plotësisht në përputhje me të dhënat e këtij rasti, Paneli do të shqyrtojë se çfarë efekti, nëse ka pasur, ky fakt i ri do të kishte pasur në Gjetjet dhe rekomandimet e tij.

Efekti i faktit të ri në gjetjet e Panelit

45. Paneli rithekson se, në përputhje me nenin 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Misioni kishte për detyrë të informojë ankuesin për ekzistencën, rrjedhën dhe bazën e hetimit të tij në këtë çështje. Paneli gjithashtu kujton se një detyrim i tillë është një element i domosdoshëm dhe i rëndësishëm i mbrojtjes së të drejtave të viktimave gjatë hetimit të një rasti të tillë. Shih, p.sh., *Desanka dhe Zoran Stanisic kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66, duke iu referuar *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-74; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 86; shih gjithashtu *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj-së i dates 6 prillit 2004, par. 311-314, *Isayeva kundër Ruisisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj-së, paragrafët 24 shkurt 2005. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i dates 7 korrik 2011, par. 167.
46. Ky detyrim është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e incidenteve të zhdukjes me forcë kur viktimat vuajnë emocionalisht nga mungesa e informacionit në lidhje me fatin e të dashurit të tyre. Shih *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87. E drejta e tyre për të vërtetën është thelbësore në një kontekst të tillë dhe autoritetet duhet të sigurojnë që të ndërmarrin hapa të duhur për ta mbrojtur atë të drejtë. Shih *Komente të Përgjithshme mbi të Drejtën e së Vërtetës në Marrëdhëniet ndaj Zhdukjes me forcë*, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë ose të pavullnetshme (2010), Dokumenti A/HRC/16/48, paragrafi 3; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87; dhe, gjithashtu, lënda I. e *Rio Negro Massacres kundër Guatemalës*, Aktgjykimi i IACtHR i datës 04.09.2012, kundërshtimi paraprak, meritat, riparimi dhe kostot, par. 265.
47. Në vendimin e tij të datës 11 shtator 2019 (paragrafi 79), Paneli tha se

‘Misioni nuk dha ndonjë shpjegim për mos mbajtjen e ankuesin (ose ndonjë të afërmi të ngushtë të viktimës primare) të informuar për këtë rast. Fakti që të dhënat e tij heshtin në atë pikë flet vetë’.
48. Sipas Misionit, fakti i ri (d.m.th. dhënia e një deklaratë nga një i afërm i ankuesit) minon gjetjet e Panelit. Për arsye të dhëna më poshtë, Paneli nuk pajtohet.
49. Së pari, shkelja e të drejtave për të cilat Misioni u gjet përgjegjës ishin ato të ankuesit - jo ato të ndonjë anëtari tjetër të familjes së tij. Duke supozuar se Misioni i përmbushi detyrimet e tij në bazë të neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me “Dëshmitarin R”, kjo nuk do ta lehtësonte atë nga detyrimet e tij ndaj ankuesit.
50. Së dyti, në fakt nuk ka asnjë provë që Misioni i ka dhënë informata “Dëshmitarit R” që do të plotësonte kriteret dhe pritjet e neneve 2 dhe 3. Prandaj nuk mund të supozohet se informacioni i rëndësishëm për ato dispozita iu ishte dhënë atij. Për më tepër, detyrimi i Misionit për të informuar të afërmit e personit të zhdukur për fatin e viktimës mbetet i vlefshëm edhe pse një anëtar i familjes më të gjerë të viktimës është ose mund të jetë në dijeni për një hetim apo gjykim që është në vazhdim e sipër.
51. Së treti, edhe nëse do të ishte kështu, nuk ka asnjë tregues se ky informacion për shkak të kësaj ishte shpërndarë nga “Dëshmitari R” me ankuesin. As nuk ishte detyrim i tij. Përkundrazi, ishte dhe mbeti gjithnjë përgjegjësia e Misionit, të cilën nuk mund t’ia delegojë palëve të treta. Për më tepër, konfidencialiteti i dëshmisë së “Dëshmitarit R” mund t’ia kishte bërë atij të pamundur për të zbuluar përfshirjen e tij në procedurë.

52. Më në fund, Paneli vëren se aplikacioni i Misionit për rishikim ka të bëjë vetëm me gjetjet e tij lidhur me mos mbajtjen të informuar të ankuesin nga Misionit në mënyrë adekuate rreth rrjedhës së hetimit të tij. Ai nuk ngriti ndonjë problem në lidhje me pjesën tjetër të gjetjeve të Panelit në lidhje me mos hetimin nga ana e tij të lëndës siç duhet. Prandaj, këto gjetje dhe rekomandime shoqëruese nuk duhet të rishqyrtohen në bazë të faktit të ri.
53. Bazuar në çfarë u përmend më sipër, dhe për arsyen e dhënë, Paneli konstaton se kërkesa e Misionit për rishikim duhet të dështojë.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

GJEN se kërkesa e Misionit nuk i plotëson kriteret e zellit dhe afatit të rregullës 43;

KONSTATON që informacioni i paraqitur nga Misioni përbën një “fakt të ri” në përputhje me rregullën 43;

KONSTATON se fakti i ri në fjalë nuk ndikon në mënyrë të rëndësishme në Vendimin e Panelit të datës 11 shtator 2019;

PRANDAJ KONFIRMON Vendimin dhe Gjetjet e tij të datës 11 shtator 2019;

PËRSËRIT se bazuar në të dhënat në dispozicion të Panelit, shkelja e të drejtave të ankuesit mund të jetë në vazhdim e sipër;

FTON MISIONIN që të konsiderojë me kujdes Rekomandimet e Panelit të datës 11 shtator 2019; dhe

PËR MË TEJ FTON MISIONIN që të informoj Panelin për hapat e ndërmarrë për zbatimin e këtyre rekomandimeve, jo më vonë se dy muaj nga marrja e këtij vendimi.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare